

KONKURS

(Për ndarje të bursave për nxënës të shkollave të mesme për vitin shkollor 2017/2018)

Fondacioni "ALBIZ" shpall konkurs për:

40 Bursa për nxënës të shkollave të mesme për vitin shkollor 2017/2018

APLIKIMI

Të drejtë për aplikim në këtë konkurs kanë nxënësit e shkollave të mesme në Republikën e Maqedonisë:

1. *Gjimnazet;*
2. *Medresetë;*
3. *Shkolla e mesme Ekonomike;*
4. *Shkolla e mesme Elektroteknike;*
5. *Shkolla e mesme e Makinerisë;*
6. *Shkolla e mesme e Mjekësisë;*
7. *Shkolla e mesme Bujqësore;*
8. *Shkolla e mesme e Tekstilit;*
9. *Shkolla e mesme për Ndërtimtari;*
10. *Shkolla e mesme Kimike dhe Teknologjisë;*
11. *Shkolla e mesme Elektroteknike;*
12. *Shkollat tjera të mesme publike në R.M*

KRITERET

- a) Të jenë nxënës të vitit të II, III dhe IV;
- b) Të jenë nxënës të rregullt;
- c) Të mos kenë përsëritur gjatë shkollimit;
- d) Të mos jenë shfrytëzues të bursave ose kredive nga ndonjë institucion apo ndërmarrje tjetër;

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM NË KONKURSION BURSA PËR NXËNËS TË SHKOLLAVE TË MESME

1. Aplikacioni (merret te fondacioni ose shkarkohet online);
2. Vërtetim se është nxënës i rregullt në vitin shkollor **2017/2018**;
3. Kopje të dëftesës për vitin e mëparshëm të arsimit;
4. Rekomandim (referencë) nga këshilli i arsimtarëve të shkollës;
5. Diploma dhe mirënjohje të fituara gjatë garave shtetërore dhe ndërkombëtare;
6. Vërtetim për të ardhurat e realizuara të anëtarëve të punësuar të familjes (për anëtarët e pensionuar fletëpagesë pensioni, për ata që marrin ndihmë sociale çekun e ndihmës sociale, ata që nuk punojnë vërtetim nga enti për punësim se nuk janë në marrëdhënie pune);
7. Kopje të ndonjë dokumenti identifikues (certifikata e lindjes, letërnjoftim, pasaportë);

Përparësi për fitimin e bursës do të kenë:

1. Nxënësit që kanë sukses të shkëlqyeshëm;
2. Nxënësit që kanë fituar çmim të parë në garat shtetërore ose çmimin e I, të II ose të III në garat ndërkombëtare nga fusha e shkencës, kulturës, teknikës, përkatësisht në profesionin që mësojnë;
3. Nxënësit që mësojnë në drejtimet deficitare;

VLERA E BURSËS

Vlera e bursës për nxënësit për vitin shkollor 2017/2018 do të jetë **1.800,00 denarë**.

Bursat ndahen gjatë tërë vitit shkollor 2017/2018 përkatësisht 9 muaj, aq sa zgjatë viti shkollor.

VENDI DHE AFATI PËR DORËZIMIN E DOKUMENTEVE

Aplikacioni dhe dokumentet e nevojshme kandidatët duhet ti dorëzojnë në zyrën e **Fondacionit “ALBIZ”** në Saraj rr. 20 nr. 97.

Aplikimet bëhen në afatin vijues :

- prej **16.10.2017 (e hënë) deri më 31.10.2017 (e martë)** nga ora 09:00 deri ora 16:00 (të shtunën deri ora 12:30)

Shpallja e rezultateve do të bëhet, pran zyrës së Fondacionit Albiz në web faqen zyrtare www.albiz.org.mk si dhe në www.facebook.com/albizfoundation.

SQARIM

1. Dokumentet duhet të dorëzohen personalisht nga vetë kandidati **(përndryshe nuk do të pranohen)**;
2. Dokumentet që janë të pakompletuara dhe që dërgohen me vonesë, përkatësisht nuk i kanë respektuar afatet kohore të konkursit, nuk do të pranohen;
3. Dokumentet e dorëzuara nuk kthehet prapë, mbeten në arkivin e fondacionit.
4. Çdo person i cili do të konkurrojë do të marrë dëshmi (numër të dosjes) se i ka dorëzuar dokumentet;
5. Rezultatet do të shpallen me numra të dosjes (jo me emra);

Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në tel. 2057 632, ose në email: info@albiz.org.mk